



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 10-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 24.11.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Smetishti, DPUMM
2. Shemsi Azemi, Shef i tatimit në pronë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë me kohë, të cilën e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 9-të e Kuvendit.
2. Informatë mbi punën e deritanishme të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, Janar-Tetor 2022.
3. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.
4. Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023.
5. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të ankesave.

Po ashtu tha se i kemi edhe 2 pika shitesë për shkak të kthimit për rishqyrtimit nga ana e ministrisë

6. Propozim Rregullore për anulimin e rregullores për vendosjen,ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15.Nr.351/06-59184 e datës, 31.10.2022
7. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 7 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 9-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 9 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 9-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Informatë mbi punën e deritanishme të Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport, Janar-Tetor 2022.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rinor Muratit Kryesues i Komitetit për Kulture Rini dhe Sport, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se është dashtë me qenë prezent edhe drejtoresha e DKRS-së në këtë takim. Këto komitete formohen për të dhënë rekomandime dhe këshillime

Egzona Bytyqi, tha se i inkurajoj dhe përgëzoj komitetet për punën që po e bëjnë dhe duhet unitet i të gjithëve për të mirën e rinisë dhe të qytetarëve të komunës tonë, po ashtu duhet bashkëpunim edhe me drejtoratet, po ashtu edhe me kryetarët e shkollave.

Do të ishte mire të kemi edhe ndonjë minibiblotejë.

Rinor Murati, ne kemi bërë një informatë në pika të shkurta por edhe kemi dhënë disa rekomandime disa Drejtoratit për disa çështje.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ju përgëzoj për këtë propozim dhe mjaft i qëlluar.

Alban Salihu, tha se në bazë të çfarë formule është bërë ky propozim, mos ka qenë mirë me qenë e përfshimë edhe VV-ja, në këtë propozim.

Daut Azemi, tha se këtë e kemi bërë në bazë të formulës së votës.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për 1 kundër, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga plani

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të ankesave.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Rregullore për anulimin e rregullores për vendosjen,ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15.Nr.351/06-59184 e datës, 31.10.2022

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi,kaloi fjalën Imri Semetishti, DPU i cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se nuk besoj qe është kthyer kjo për çështje politike. Ju si drejtor keni rënë në pozitë jo te mire pasi qe e keni gjetë këtë drejtorat ne gjendje jo te mirë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi Ia kaloi fjalën Shemsi Azemi, shef i tatimit në pronë i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14:55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi